



Partia Demokratike

SEKRETARI PËRGJITHSHËM

Nr. 650/ prot.

Tiranë, më: 2/12/2025

UDHËZIM

Nr. 6, datë 2.12.2025

“ MBI PROCESIN E ANALIZËS SË BRENDSHME PAS ZGJEDHJEVE TË 11 MAJIT ”

Në mbështetje të nenit 46 të Statutit të Partisë Demokratike, pas vendimit të Kryesisë së Partisë Demokratike të datës 3 Nëntor 2025 për fillimin e procesit të analizës së brendshme lidhur me zgjedhjet e përgjithshme të 11 Majit 2025, si dhe në vijim të vendimit të Kryesisë nr. 86, datë 18.11.2025 “Për hapjen e procesit të zgjedhjeve në disa Degë të PDSH”,

UDHËZOJ:

1. Në të gjitha Degët e Partisë Demokratike të nisë procesi i analizës së brendshme lidhur me Zgjedhjet e Përgjithshme të 11 Majit 2025, me fokus objektivat e mëposhtme:

- a) analiza e rezultatit në çdo qendër votimi dhe krahasimi me historikun elektoral të Partisë Demokratike (2009-2025), duke evidentuar në mënyrë të plotë të gjitha rrethanat që kanë ndikuar pozitivisht apo negativisht në rezultat sipas çdo qendre votimi;
- b) analiza e faktorëve të brendshëm organizativ – në nivel seksioni, grupseksioni, dege dhe kandidatët për deputet – që kanë ndikuar pozitivisht apo negativisht në rezultat;
- c) analizë të nevojës për përmirësim të faktorëve të brendshëm organizativ – në nivel seksioni, grupseksioni dhe dege, përgjegjësitë përkatëse, duke propozuar sugjerime për organet drejtuese të Partisë lidhur me nevojën e përmirësimit të organizimit të brendshëm apo ndryshimeve në Statutin e Partisë.

2. Analiza në nivel Dege drejtohet nga Kryesia e Degës, nën përgjegjësinë e Koordinatorit të Posaçëm të Kryetarit të Partisë që udhëheq këtë proces. Me qëllim garantimin e një analizë gjithëpërfshirëse, transparente dhe të drejtë, duke respektuar parimin e shmangies së konfliktit të interesit, për të udhëhequr procesin e analizës në secilin qark caktohet një apo më shumë Koordinator të Posaçëm, sipas listës dhe ndarjes në Ankesin 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Koordinatori i Posaçëm në nivel qarku merr menjëherë kontakt me Kryetarin dhe Sekretarin e Degës, për të caktuar mbledhjen e Kryesisë së Degës, me rend dite: “Përcaktimin e kalendarit të

mbledhjeve për kryerjen e analizës”. Ai kujdeset që të gjithë anëtarët e Kryesisë të jenë njoftuar rregullisht.

4. Mbledhjet për kryerjen e analizës do të realizohen në nivel Rajoni (një apo disa grupseksione bashkë) ose në nivel grupseksioni, sipas vlerësimit që bën secila Kryesi e Partisë në nivel lokal. Kalandari i mbledhjeve i bëhet transparent çdo anëtar i Partisë Demokratike në rajonin apo grupseksionin përkatës. Në mbledhje ftohet të marrin pjesë strukturat e degës, kandidatët për deputet dhe çdo anëtar i Partisë Demokratike që aderohet në atë grupseksion. Në çdo mbledhje merr pjesë detyrimisht Kryetari dhe sekretari i Degës, si dhe anëtarët e Kryesisë së Partisë që mbulojnë territorin përkatës.

5. Mbledhja e analizës drejtohet nga Koordinator i Posaçëm, i cili siguron që secili anëtar i partisë të ketë mundësi të shprehë lirisht mendimin e tij mbi të tre objektivat e analizës të përcaktuara në pikën 1 të këtij urdhri, si dhe të respektohen parimet e funksionimit të partisë të saksionuara në nenin 9 të Statutit të Partisë. Ai kujdeset që secili mendim i shprehur të regjistrohet dhe mbahet shënim saktësisht siç është shprehur.

6. Koordinator i Posaçëm raporton në mënyrë të përjavshme mbi ecurinë e procesit të analizës tek Kryetari i Partisë dhe Sekretari i Përgjithshëm. Gjatë ushtrimit të përgjegjësisë së tij sipas këtij udhëzimi, Koordinator i Posaçëm mund të kërkojë që të ndihmohet nga një grup pune për secilin qark, që përbëhet nga anëtarë të Këshillit Kombëtar të PD, duke respektuar parimin e shmangies së konfliktit të interesit. Në rast se kërkohet, numri dhe përbërja e çdo grupi pune për secilin qark caktohet nga Sekretari i Përgjithshëm, në bashkëpunim me Kryetarin e Këshillit Kombëtar.

7. Në përfundim të të gjitha mbledhjeve sipas pikës 4 të këtij udhëzimi, përpara hartimit të Raportit të Analizës për secilën degë dhe në nivel qarku, Koordinator i Posaçëm analizon gjetjet në një mbledhje të posaçme të Kryesisë së Partisë në secilën Degë brenda qarkut që mbulon. Pasi ka diskutuar gjetjet edhe me Kryesinë e Partisë, Koordinator i Posaçëm harton Raportin Përfundimtar të Analizës, të cilin ja njofton Kryetarit të Partisë dhe Kryesisë së PDSH, brenda datës 31.01.2026.

8. Kryesia e PDSH merr në shqyrtim të gjitha Raportet e Analizës për secilin qark, dhe analizon nevojën për përmirësim të faktorëve të brendshëm organizativ – në nivel seksioni, grupseksioni dhe dege, apo struktura qendrore të Partisë, përgjegjësitë përkatëse, duke propozuar sugjerime për organet drejtuese të Partisë lidhur me nevojën e përmirësimit të organizimit të brendshëm apo ndryshimeve në Statutin e Partisë.

9. Për degët e Partisë që janë përfshirë në procesin zgjedhor sipas vendimit nr. 86, datë 18.11.2025, procesi i analizës do të kryhet sëbashku me proceset statuto-re zgjedhore. Për këtë arsye, sipas udhëzimeve të KOKOE ata ndjekin edhe procesin zgjedhor në Degët përkatëse që përfshihen brenda qarkut ku janë caktuar përgjegjës, duke ndjekur zbatimin e udhëzimit nr. 5, datë 25.11.2025 të Sekretarit të Përgjithshëm “Mbi mbajtjen e zgjedhjeve në Degët e Partisë Demokratike me Drejtues të komanduar”.

10. Ngarkohet Sekretariati Organizativ, të gjitha Degët e Partisë Demokratike, si dhe Koordinatorët e Posaçëm, për ndjekjen dhe zbatimin e këtij udhëzimi.

11. Ngarkohet Sekretariati Organizativ i Partisë për njoftimin e këtij udhëzimi të gjitha Degëve të Partisë, si dhe Sekretarët e Degëve për njoftimin e të gjithë anëtarëve të Kryesisë së Degëve dhe Kryetarëve të Grupseksioneve.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Flamur NOKA

